



Në bazë të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutit të Kolegjit AAB, Senati në mbledhjen e mbajtur me datën 17.05.2019 miraton këtë:

Kodi i Etikës **Për stafin akademik të Kolegjit AAB**

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Ky Kod i Etikës është përpiluar duke u bazuar në parimet bazë të parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë për të siguruar një kornizë të rregullave me qëllim të sigurimit të lirisë akademike, krijimit të mundësive të barabarta për personelin akademik, për të përmirësuar klimën organizative dhe mjedisin e punës, duke favorizuar shfaqjen e sjelljeve të virtutshme dhe parandalimin e sjelljes joetike.

Neni 2

Ky Kod i etikës zbatohet për gjithë stafin akademik pavarësisht angazhimit se a është i rregullt apo i angazhuar.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i këtij Kodi është të përcaktoj sjelljen etike të personelit akademik në Kolegjin AAB.

Neni 4

Vlerat thelbësore të arsimit të lartë

Vlerat thelbësore të arsimit të lartë që duhet të kihen parasysh nga stafi akademik në punë e tyre janë:

1. Liria Akademike
2. Autonomia Institucionale
3. Përgjegjësia Sociale

4. Qasje e barabartë
5. Llogaridhënia
6. Mbrojtja e pronës intelektuale

Neni 5

Parimet

1. Pjesëtarët e personelit akademik, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë të cilët janë pjesë e institucionit, pritet të sillen në përputhje me parimet e përgjithshme të etikës siç janë:
 - a. integriteti
 - b. ndershmëria
 - c. e vërteta
 - d. transparenca
 - e. respektimi i të tjerëve
 - f. besimi
 - g. llogaridhënia
 - h. paanshmëria
 - i. barazia
 - j. drejtësia
 - k. altruizmi
 - l. objektiviteti
 - m. liria akademike.
2. Këto parime vlejné në raport me:
 - a. organin qeverisës, drejtuesit dhe organe të tjera të institucionit
 - b. personelin akademik dhe administrativ
 - c. studentet dhe
 - d. çdo person tjetër apo grup që ka marrëdhënie kontraktuale ose të një lloji tjetër apo interes për punën e institucionit.

Neni 6

Rregullat kryesore

Ne mbështetje të këtyre parimeve të përgjithshme, personeli/t akademik:

1. duhet të vendosin interesat e institucionit mbi interesat e tyre dhe nuk duhet të kërkojnë të përfitojnë nga pozitat e tyre në mënyra të ndryshme nga ato që parashikojné rregulloret e institucionit dhe legjislacioni në fuqi;
2. nuk duhet të pranojnë asnjë udhëzim për veprim ose mosveprim në një mënyrë të caktuar nga asnjë individ - me përjashtim të një autoriteti epror, nga asnjë parti politike, sindikate ose grup fetar, me përjashtim të atyre që parashikon legjislacioni në fuqi;
3. në lidhje me persona ose grupe brenda apo jashtë institucionit, nuk duhet të kërkojnë e as të pranojnë ryshfete apo shpërblime të tjera të paligjshme financiare, ose të kërkojnë apo pranojnë ndonjë nder tjetër personal, që mund t'i ndikojë në punën e tyre dhe duhet të njoftojné menjëherë për çdo përpjekje

- për të kërkuar ryshfet apo ndere të tjera personale autoritetin përkatës që përcaktohet në Rregulloren e institucionit;
4. duhet t'i paraqesin një deklaratë me shkrim Rektorit, nëse ata ose një familjar i afërt kanë interesa personale në çështje që ndikojnë punën e tyre - burimet njerëzore (përfshi emërimet dhe rritje në detyre të personelit), çështjet financiare, kontraktuale apo probleme të tjera lidhur me to;
 5. nuk duhet të keqpërdorin burimet e institucionit apo informacionin personal ose tregtar që zotërohet nga ai, përfshi pronësinë intelektuale, për përfitime vetjake apo të një personi ose grupi tjetër;
 6. kur marrin pjesë në emërimin, ngritjen në detyre apo komisione të tjera që ndikojnë në personelin akademik, duhet të sillen me profesionalizëm dhe në përputhje me parimet etike të renditura më sipër;
 7. kur marrin pjesë në komisione ose organe të tjera që merren me pranimin, vlerësimin, provimin dhe veprime të tjera që lidhen me studentët, si dhe në aktivitete individuale dhe në grup me studentët, duhet të sillen me profesionalizëm dhe në përputhje me parimet etike të renditura më sipër;
 8. kur marrin pjesë në veprimtari kërkimore, nuk duhet të përfshihet në plagjiaturë, të shesë punën e të tjerëve si të veten apo të falsifikojë rezultatet dhe duhet të respektojë parimet etike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe parime të tjera të caktuara në fusha të tjera;
 9. duhet të përmbahen nga veprimet me të cilat mund t'i sjellin dëm institucionit duke mos zbatuar obligimet kontraktuale gjatë kohëzgjatjes së kontratës;
 10. ndalohet çfarëdo forme e kushtëzimit, shfrytëzimit, ngacmimit apo trajtimi diskriminues të studentëve apo duke vendosur kushte për kalimin e provimit, blerjen e literaturës së caktuar, ose duke kërkuar favore politike, financiare, seksuale ose favore tjera;
 11. ndalohet çdo sjellje në raport me kolegët dhe stafin tjetër të institucionit me qëllim të ndonjë përfitimi personal apo ndonjë personi të tretë;
 12. Institucioni promovon një mjedis të favorshëm për diskutim, njeh lirinë e plotë të mendimit dhe shprehjes edhe në formë kritike, por, në rast të mbajtjes të ndonjë pozite menaxheriale brenda institucionit, atëherë duhet të përmbahet nga deklaratimet publike me përmbajtje fyese, politike, fetare etj.
 13. ndalohet çdo formë e diskriminimit në baza politike, racore, fetare, gjinore, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike, origjinës kombëtare, prejardhjes, statusit martesor, paafësisë fizike apo mendore;
 14. obligohet të respektojë afatet kohore të përcaktuara lidhur me orarin e ligjëratave, ushtrimeve, provimeve, konsultimeve, kohën e mbledhjeve të përcaktuara nga institucioni, dhe vetëm në raste të veçanta apo pas miratimit nga institucioni lejohen përjashtime;
 15. duhet të përmbahet nga deklaratime me përmbajtje fyese ndaj të gjithë personelit të institucionit por edhe ndaj personave të tretë që nuk janë pjesë e institucionit;
 16. duhet të kujdeset që sa më mirë të përfaqësojë institucionin duke kontribuar në ngritjen e imazhit dhe jo të kundërtën;
 17. personeli akademik i rregullt duhet të paraqesë përkatësinë (punëdhënësin) e tij në të gjitha rrjetet sociale, platformat elektronike apo edhe në vende tjera, duke shmangur shpërndarjen e informacionit, teksteve ose imazheve që mund të dëmtojnë emrin dhe prestigjin e institucionit;

18. duhet të paraqesin-denoncojnë sjelljet joetike të kolegëve të tyre ose shkeljen e dispozitave të këtij kodi apo rregullave tjera të institucionit;
19. ndalohet shtyrja apo nxitja e të tjerëve për mos respektimin e rregullave të institucionit apo në veprime tjera të ndaluara;
20. ndalohet përdorimi i paautorizuar i burimeve të institucionit për qëllime të përfitimit personal, për qëllime politike, fetare etj;
21. ndalohet përdorimi i autoritetit, pozitës apo emrit të institucionit për përfitime personale me palë të treta ose jashtë institucionit;
22. ndalohen të gjitha format e lobimit, shantazhit, kërcënimit, ryshfetit, korrupsionit dhe veprime tjera që bien ndesh me profesionin e mësimdhënësit.

Neni 7

Komisioni i etikës

1. Senati në bazë të këtij kodi, do të themelojë Komisionin e etikës i cili do të ketë 3 anëtarë nga radhët e mësimdhënësve të institucionit;
2. Propozimet për anëtar të komisionit i bënë Rektori;
3. Se paku njëri nga anëtarët e Komisionit të Etikës duhet të jetë nga fusha e drejtësisë;
4. Mandati i anëtarëve të Komisionit të etikës është 4 vjeçar;

Neni 8

1. Anëtari mund të bëhet i papërshtatshëm për të qenë pjesë e Komisionit të etikës nëse:
 - a. Mungon më shumë se 3 here në mbledhje të komisionit;
 - b. Nuk është më pjesë e personelit akademik të institucionit;
 - c. Nuk kryen obligimet që ka ndaj komisionit;
 - d. Dhe për shkaqe tjera që ndikojnë drejtpërdrejt në punën e Komisionit të etikës.
2. Nëse paraqitet ndonjëri prej rasteve të parapara në pikën 1, atëherë Rektori mund të plotësojë Komisionin e etikës me anëtar të ri për pjesën e mbetur të mandatit.

Neni 9

1. Komisioni i etikës është përgjegjës për trajtimin dhe vendosjen në shkallë të parë për të gjitha shkeljet e personelit akademik;
2. Ndaj vendimeve të Komisionit të etikës në afat prej 15 ditësh, është e lejuar ankesa në Këshillin Drejtues;
3. Ankesa ndaj vendimeve të Komisionit të etikës e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 10

1. Komisioni i etikës ndaj një personeli akademik mund të shqiptojë një vërejtje me shkrim, ndëshkim financiar dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës;

2. Komisioni i etikës mund të shqiptojë edhe masa tjera që i vlerëson të arsyeshme dhe që ndikojnë pozitivisht në përmasimin e sjelljes.

Neni 11

1. Komisioni i etikës mund të nxjerrë rregullore të punës dhe të përcaktojë mënyrën e marrjes së vendimeve;
2. Vendimet Komisioni i etikës i merr në bazë të provave të siguruara, deklaratave dhe duke organizuar seancë dëgjimore për personin e denoncuar.
3. Të drejtën e paraqitjes-denoncimit të shkeljeve e ka çdo kush qoftë person i brendshëm i punësuar në institucion apo edhe i jashtëm;
4. Shkelja mund t'i adresohet drejtpërdrejt Komisionit të etikës, ose përmes Rektorit apo Dekanit të Fakultetit;

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky Kod i Etikës hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati.



Dr. Lulzim Tafa, Rektor



Senati i Kolegjit AAB, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2019 mori këtë:


V E N D I M

1. MIRATOHET Kodi i Etikës për stafin akademik të Kolegjit AAB.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Prorektorëve
2. Sekretarit
3. Dekanëve
4. Anëtarëve të Komisionit të Etikës




Dr.sc. Lulzim Tafa, Rektor